



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:226135

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05718512

C.nr.1001/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridike të paditëses V.V nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, lidhur me kompensimin e dëmit jo material dhe dëmtimit të reputacionit, vlera e kontestit 9,000.00 euro, jashtë seance, me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditëses V.V nga Rahoveci, e ushtruar pranë kësaj gjykate, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, lidhur me kompensimin e dëmit jo material dhe dëmtimit të reputacionit, vlera e kontestit 9,000.00 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

III. Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësja V.V nga Rahoveci, nëpërmjet përfaqësueses së saj të autorizuar, me datë 06.10.2021, ka ushtruar padinë kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, lidhur me kompensimin e dëmit jo material dhe dëmtimit të reputacionit, vlera e kontestit 9,000.00 euro.

Paditësja V.V, në seancën e datës 21.05.2024, ka deklaruar se tërhiqet nga padia e datës 06.10.2021, pasi që nuk dëshiron të vazhdoj me këtë çështje, sepse ka kaluar një kohë e gjatë dhe kanë ndryshuar rrethanat në raport me punëdhënësin-të paditurën.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës av. B.O ka deklaruar se nuk e kundërshton tërheqjen e padisë dhe nuk i kërkon shpenzimet procedurale.

Andaj kjo gjykatë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 261 paragrafi 2 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se padia e paditësit është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC

C.nr.1001/2020, më 22.05.2024

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë.